

REPubLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1446/4 prot.

Tiranë, më 02.05.2023

V E N D I M

Nr. 32, datë 02.05.2023

PËR

“MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, QË PËRFITOJNË BURSË SIPAS KRITERIT EKONOMIK, FAZA IV, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, TË CILËT STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË INTEGRUAR, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim Relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 1327, datë 20.04.2023 “Mbi miratimin e listave të studentëve që përfitojnë bursë, për vitin akademik 2022-2023 sipas kriterit ekonomik, faza e katërt”, në mbledhjen e datës 02.05.2023, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e 10 (dhjetë) studentëve, që përfitojnë bursë sipas kriterit ekonomik për vitin akademik 2022-2023, faza IV, të cilët studiojnë në një program studimi të ciklit të parë dhe në një program studimi të integruar, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekti financiar total në vlerën 450,000 (katërqind e pesëdhjetë mijë), përballohet nga Buxheti i Shtetit, si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

VERA OSTRENI

MONIKA FIDA

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ